



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A

Nr prot

Dt /11/2022

ARGUMENTIM I KERKESAVE PER KUALIFIKIM

Bazuar ne Vendim Nr 285 date 19.05.2021 per ‘MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK’ neni 41 ‘KERKESA TE VECANTA PER KONTRATAT E SHERBIMEVE’, neni 55 ‘PROCEDURE HAPUR E THJESHTUAR’

Ligji Nr 162/2020 ‘PER PROKURIMIN PUBLIK’ neni 49 ‘PROCEDURE E HAPUR E THJESHTUAR’, neni 74 ‘DOKUMENTAT E TENDERIT’, neni 77 ‘KERKESAT PER KUALIFIKIM’.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;



SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A

- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë printime dhe zarfime selfmailer

Ofertuesi duhet të paraqesë një vertetim që ka paguar detyrimet e ujit të pijshëm dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr. 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019,2020,2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% e fondit limit.

a) **Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3 të LPP dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 41 pika 2.**

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.



SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- d) **Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4 të LPP dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 41 pika 3.**

2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas **Standarteve ISO** të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001 : 2015** “Për sistemin e menaxhimit të Cilësisë” ose *ekuivalente* (e vlefshme).
- **ISO 27001 : 2018** “Për Sigurinë e Informacionit” ose *ekuivalente* (e vlefshme).
- **Argumentimi: Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojne menaxhim te larte bazuar ne standardet nderkombetare te vendosura ne perputhje me legjisacionin nderkombetar qe e rregullon kete fushe.**

- **2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronësi ose me qera jo me pak se **2 (dy) makineri printimi digitale me ngjyra**, me shpejtësi min 20.000 copë fatura A4 në ditë secila (shoqëruar me kartelën teknike).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9).



SHOQËRIA RAJONALE UJËS JELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4 të LPP dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 41 pika 6.

Autoriteti kontraktor ne varesi te natyres se sherbimit ,kekron nga pjesmarresit ne proceduren e prokurimit paisjet te cilat do te realizojne sherbimin e kerkuar brenda afateve te percaktuara.

Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor, për makineritë e mësipërme do të kërkojë nga OE fitues dokumentacionin si më poshtë:

- Kur janë në pronësi: faturë tatimore shitblerje ose deklaratë zhdoganimi ose cdo formë tjetër të ligjshme disponimi.
- Kur janë me qira: Kontratë Qiraje të noterizuar si edhe dokumentat e pronësisë së qiradhënësit (original ose fotokopje e noterizuar).
- **2.3.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të ketë të gjitha masat mbrojtëse për mbrojtjen e fileve nga humbja, vjedhja apo aksesit i paautorizuar.
- **Ky kriter** kupton transferimin e fileve nga vendi i prodhimit pranë AK me sukses, që do të thotë: shmangjen e humbjes, vjedhjes apo aksesit të paautorizuar (*hakerimi*).
- Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin një Vetëdeklarim nga Administratori i shoqërisë, tek i cili deklaron nën përgjegjësinë e tij të plotë se disponon të gjitha masat mbrojtëse për mbrojtjen e fileve nga humbja, vjedhja apo aksesit i paautorizuar (*hakerimi*).
- **2.3.5.** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një Vetëdeklarim nga Administratori i Shoqërisë ku merr përsipër transportin mujor të faturave pranë Sh.a.UKGJ, të cilat do të dorëzohen pranë Drejtorisë Tregtare, Sektori i Shitjes me procesverbal bashkangjitur.
- **2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në të cilën deklaron se do të ketë **Sistem Software** (sisteme operative dhe aplikacione) dhe **Hardware** për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e fileve për print. Ky sistem duhet të jetë në ambjent të mbyllur dhe të dedikuar, vëzhguar me kamera 24H/24.
- **2.3.7.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në të cilën deklaron se do të dorëzojë faturat të vendosura në zarf (**Self Mailer**), i cili do të behet në zyrat qendrore të Sh.a UKGJ-se , brenda 48 H, konkretisht tek Drejtoria Tregtare, Sektori Shitjes, me procesverbal bashkangjitur.
- Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, të LPP dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 41.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A

- Autoriteti kontraktor ne varesi te natyres se sherbimit kerkon [arawqitjern e deklarave nga ana e operatoreve ekonomik te cilen do te deklarojne nese i permbushin pikat e mesiprme per realizimin eketij sherbimi.
 - Gjithashte AK rezervon te drejten e verifikimit te ketij informacioni i cili luan nje rol te rendesishem ne kete procedure.
 - Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT

Altin Ajdini

Bexhet Baxhella

Brisilda Papa